



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



METODOLOGJIA ZRRE/NR. 01/2020

METODOLOGJIA PËR LLOGARITJEN E ÇMIMIT REFERENT PËR ENERGINË E PRODHUAR NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME

Dhjetor, 2020

Prishtinë

Përmbajtja

| | |
|--|---|
| KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME | 3 |
| Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi..... | 3 |
| Neni 2 Përkufizimet dhe Interpretimet..... | 3 |
| Neni 3 Konteksti | 4 |
| Neni 4 Parimet dhe konceptet | 4 |
| KREU II Metodologjia për të llogaritur çmimin referent për orë | 7 |
| Neni 5 Mënyra e llogaritjes | 7 |
| KREU III DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE | 8 |
| Neni 6 Ndryshimi..... | 8 |
| Neni 7 Interpretimi..... | 8 |
| Neni 8 Hyrja në fuqi..... | 8 |

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 26 dhe Nenin 47 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185, në seancën e mbajtur me 10.12.2020, miratoi:

METODOLOGJIA PËR LLOGARITJEN E ÇMIMIT REFERENT PËR ENERGINË E PRODHUAR NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1 Kjo metodologji definon mënyrën e përcaktimit të çmimit referent për energjinë e prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë (BRE). Ky çmim do të aplikohet nga Operatori i Tregut për energjinë e shitur tek Furnizuesit. I njëjti do të aplikohet edhe për shitblerjen e energjisë nga BRE sipas kornizës së rregulluar.
- 2 Kjo metodologji përcakton:
 - 2.1 Parimet themelore sipas së cilave do kalkulohet çmimi referent; dhe,
 - 2.2 Metodën e llogaritjes së çmimit referent.

Neni 2 Përkufizimet dhe Interpretimet

- 1 Termat vijues që përdoren në këtë metodologji kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1 *“Burim i energjisë së ripërtërishme”* - burim i ripërtërishëm, jofosil i energjisë si: energjia e erës, energjia diellit, energjia gjeotermale, energjia e ujit, energjia e valëve, biomasa, gaz i mbetjeve urbane, gaz i mbetjeve të trajtimit të ujërave dhe biogazi; siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për burimet e energjisë së ripërtërishme;
 - 1.2 *“Çmimi referent”* –Llogaritet duke përdorur metodologjinë e kostos së anashkaluar dhe radhitjen e prodhimit sipas renditjes meritore bazuar në prodhimin më të shtrenjtë së pari dhe prodhimin më të lirë së fundi.
 - 1.3 *“Konsumator me shumicë (tregtar)”* - person fizik ose juridik që blenë energji elektrike me qëllim të rishitjes brenda apo jashtë sistemit në të cilin është themeluar;
 - 1.4 *“Furnizuesi i shërbimit universal - FSHU”* – është furnizuesi të cilit i është vendosur një obligim i shërbimit publik nga rregullatori për të siguruar shërbim universal me kushte të rregulluara për konsumatorët familjar dhe jofamiljar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë së dhjetë (10) milion euro ose jo më shumë së pesëdhjetë (50) punëtorë.
 - 1.5 *“Konsumator i shërbimit universal”* - nënkupton një konsumator që ka të drejtën e shërbimit universal sipas kuptimit të nenit 37.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

- 1.6 "Çmimet e importit"—çmimet për importe që furnizojnë të gjithë konsumatorët për momentin të përcaktuar nga Bursa Hungareze e Energjisë por eventualisht nga Bursa Shqiptare e Energjisë.
- 2 Shprehjet tjera të përdorura në këtë dokument do të kenë kuptimin e njëjtë sikurse në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Energjinë.

Neni 3 Konteksti


- 1 Përgjithësisht si burime kryesore që kontribuojnë në furnizimin me energji elektrike në Kosovë janë:
- 1.1 Gjenerimi vendor i kontraktuar që të ofrohet për furnizim për konsumatorët e FSHU.
 - 1.2 Gjenerimi vendor i kontraktuar që të ofrohet për furnizim për konsumatorët e jo-FSHU.
 - 1.3 Importi i energjisë.
 - 1.4 Gjenerimi vendor nga BRE që është një formë tjetër e shitjes së energjisë krahas skemës mbështetëse, por nuk përfshihet në kalkulimin e çmimit referent.
- 2 Çmimi referent është kostoja e shmangur e kërkesës së energjisë elektrike të zëvendësuar nga BRE-të bazuar në renditjen meritore d.m.th. gjenerimi më i shtrenjtë i shmangur i energjisë elektrike që është zëvendësuar nga BRE-të.
- 3 Llogaritja e çmimit referent kërkon informata lidhur me:
- 3.1 Sasinë e gjenerimit të BRE-ve;
 - 3.2 Renditjen meritore duke supozuar se s'ka gjenerim nga BRE; dhe
 - 3.3 Çmimi i energjisë që do të zhvendosej.

Neni 4 Parimet dhe konceptet

- 1 Çmimi referent mund të llogaritet për çfarëdo periudhe kohore d.m.th. mund të llogaritet në bazë të orëve tremujore ose vjetore. Për qëllim të kësaj metodologjie aplikohet çmimi referent i llogaritur në baza vjetore.
- 2 Sasia e kërkesës së zhvendosur është bazuar në renditjen meritore të kërkesës me burimin më të shtrenjtë gjenerues të zëvendësuar së pari dhe burimin më të lirë të zëvendësuar së fundi.
- 3 Çmimi referent për orë bazohet në vëllimin e gjenerimit nga BRE dhe kostot e alternativave të zhvendosura në atë kohë për atë vëllim. Çmimi përcaktohet duke zhvendosur kërkesën e disa gjeneruesve. Prandaj, nëse gjenerimi nga BRE-të do të ishte 5 GWh dhe gjeneruesi më i shtrenjtë i shmangur prodhon 2 GWh, atëherë 3 GWh shtesë nga burimi tjetër më i shtrenjtë gjithashtu do të zhvendosej. Prandaj, shmangia e 5 GWh të gjenerimit nga BRE-të do të bazohet në çmimet e matura dhe vëllimet nga gjeneruesit e ndryshëm. Parimi i njëjtë do të aplikohet për disa gjenerues ose për vetëm një gjenerues.

- 4 Llogaritja e çmimit vjetor referent bazohet në vlerat aktuale të burimeve të zhvendosura të energjisë elektrike për orë për të gjithë vitin dhe pjesëtimi me vëllimin e pritur të gjenerimit nga BRE-të për orë për të gjithë vitin.
- 5 Kostoja e gjenerimit dallon sipas burimeve të ndryshme:
- 5.1 Kostoja e importit përcaktohet nga çmimet e tregut në Bursën Hungareze të Energjisë minus koston e të drejtës së transmisionit që duhet siguruar. Pasi të lansohet Bursa Shqiptare e Energjisë, që do të funksionojnë gjithashtu si Bursa Kosovare e Energjisë, do të tregoj çmimet e ardhshme të tregut për importet
 - 5.2 Kostoja e energjisë me shumicë për furnizim të konsumatorëve me të drejtë të Shërbimit Universal.
 - 5.3 **Kostoja e energjisë me shumicë për konsumatorët e jo-FSHU (të derregulluar).**
 - 5.4 Kostoja e gjenerimit nga BRE-të me shumicë në skemën mbështetëse dhe në kornizën rregulluese nuk përfshihen në kalkulimin e çmimit referent dhe nuk kanë relevancë për çmimin referent (siç e thotë definicioni është i bazuar në çmimin e ngarkesës së shmangur nga burimet tjera gjeneruese).
- 6 Figura 1 më poshtë ilustron se si mund të duket renditja meritore që përdoret për llogaritjen e çmimit referent për Kosovën. Do të ndryshojë përgjatë lakores vjetore të ngarkesës varësisht nga burimi gjenerues. Figura gjithashtu paraqet gjenerimin hipotetik të BRE-ve.
- 7 Nga Figura 1, mund të shohim tri faza kryesore:
- 7.1 A: çmimi referent varet nga kostoja e importit.
 - 7.2 B: çmimi referent fillimisht varet nga çmimi i importit dhe pastaj nga çmimi me shumicë i energjisë elektrike të shitur për konsumatorët e jo-FSHU.
 - 7.3 C: çmimi referent fillimisht varet nga çmimet me shumicë për konsumatorët e jo-FSHU, dhe pastaj në rast të tepicës mbulohet kërkesa e konsumatorëve të FSHU-se me çmimet e energjisë për konsumatorët me Shërbim Universal (FSHU).

Figura 1 - Analiza e çmimit referent për gjatë lakores vjetore të ngarkesës për orë



8 Është e rëndësishme të vërehen kompleksitetet vijuese konceptuale:

- 8.1 Vëllimet e parashikuara të gjenerimit nga BRE-të mund të ndryshojnë gjatë vitit për shkak të sezonalitetit (apo faktorët e motit gjatë ditës në rast të energjisë solare apo të erës) apo për shkak të centraleve të reja nga BRE-të që mund të komisionohen gjatë vitit.
- 8.2 Çmimet e energjisë me shumicë për konsumatorët jo-FSHU mund të bazohen në maksimizimin e profitit, rrjedhimisht gjeneruesit relevant mund të aplikojnë çmimet maksimale të mundshme. Në kontekstin e Kosovës, mund të jetë konsumatori alternativ ku gjeneruesi mund të shes, për të cilin, çmimi do të përcaktohej nga Bursa të besueshme të energjisë (siç mund të jetë Bursa Hungareze, Bursa Shqiptare etj).

KREU II

METODOLOGJIA PËR LLOGARITJEN E ÇMIMIT REFERENT

Neni 5

Mënyra e llogaritjes

- 1 Bazuar në konceptet dhe parimet e përmbledhura më sipër, është krijuar një ekuacion për të llogaritur çmimin referent si në vijim:

$$G_{g,h} = \text{minimum}(\text{burimi i energjisë}_{g,h}, \text{Mbetja } BRE_{g,h})$$

$$\text{Mbetja } BRE_{g,h} = G_{g-1,h}$$

$$\text{Mbetja } BRE_{0,h} = BRE_h$$

$$X_{g,h} = G_{g,h} \times \text{Price}_{g,h}$$

$$\text{Çmimi referent} = \frac{\sum_{h=1}^{8760} \sum_{g=1}^n X_{g,h}}{\sum_{h=1}^{8760} BRE_h}$$

ku:

| | |
|----------------------------|---|
| h | është një orë në vitin e aktual; |
| g | është burimi i energjisë elektrike (importet, çmimet e energjisë me shumicë për konsumatorët nga FSHU dhe konsumatorët nga jo-FSHU); |
| n | është numri i burimeve të energjisë elektrike në llogaritje; |
| BRE_h | është vëllimi i aktual i gjenerimit nga BRE që do të shitet nga OT në orën h ; |
| $\text{Mbetja } BRE_{g,h}$ | është vëllimi i gjenerimit të BRE që është ende në dispozicion për të zhvendosur burimin gjenerues g pas zhvendosjes së burimit gjenerues $g-1$ në orën h ; |
| $G_{g,h}$ | është variabla që tregon vëllimin e një burimi gjenerues g të zhvendosur nga BRE në orën h ; |
| $\text{Çmimi}_{g,h}$ | është vlera e aktuale për MWh të burimit gjenerues g të zhvendosur nga BRE në orën h ; |
| $X_{g,h}$ | është vlera e burimit gjenerues g të zhvendosur nga BRE në orën h . |

KREU III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 6 Ndryshimi

- 1 Rregullatori mban të drejtën që të ndryshoj ose modifikoj çdo dispozitë të kësaj metodologjie.
- 2 Procedurat për modifikimin apo ndryshimin e kësaj metodologjie do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 7 Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj metodologjie, Bordi do të ofroj informacione sqaruese.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Kjo metodologji hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar